29.12.2023 – 24.03.2024

# GJYQE




# TRIALS

Kuruar nga / Curated by
Zef Paci / Luçjan Bedeni / Lek M. Gjeloshi

ORARI
E martë – E shtunë: 09:00–16:00
E diel: 10:00–15:00

BILETA

| | |
|---|---|
| → Biletë individuale (në sportel) | 700 Lekë |
| → Biletë individuale (www.myticket.al) | 600 Lekë |
| → Biletë grupi +12 | 600 Lekë |
| → Jetimët, invalidët, pensionistët | 350 Lekë |
| → Studentët, fëmijë nga mosha 12–18 | 210 Lekë |
| → Fëmijë nën 12 | 0 Lekë |
| → Veteranë lufte | 0 Lekë |
| → Ish të dënuar dhe të përndjekur politikë | 0 Lekë |
| → Invalidë paraplegjikë dhe tetraplegjikë | |
| → Studentë dhe nxënës shkollash në kuadër të zhvillimeve të orëve mësimore apo programit “Edukimi përmes kulturës” | 0 Lekë |
| → Anëtarët ICOMOS - ICOM | 0 Lekë |
| → Punonjësit e ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe institucioneve në varësi të kësaj ministrie | 0 Lekë |
| → Delegacionet zyrtare shtetërore | 0 Lekë |

HOURS
Tuesday – Saturday: 09:00–16:00
Sunday: 10:00–15:00

ADMISSION

| | |
|---|---|
| → Adults (reception desk) | 700 Lekë |
| → Adults (www.myticket.al) | 600 Lekë |
| → Groups over 12 | 600 Lekë |
| → Orphans, people with disabilities, seniors | 350 Lekë |
| → Students, pupils (ages 12–18) | 210 Lekë |
| → Children under the age of 12 | 0 Lekë |
| → War veterans | 0 Lekë |
| → Former political prisoners | 0 Lekë |
| → Paraplegic and tetraplegic invalids | |
| → Albanian students and pupils visiting the museum during lesson hours or the program “Education through culture” | 0 Lekë |
| → ICOMOS – ICOM members | 0 Lekë |
| → Staff of the Ministry responsible for cultural heritage and subordinate institutions of the above mentioned Ministry | 0 Lekë |
| → National delegations | 0 Lekë |

MUZEU KOMBËTAR I FOTOGRAFISË “MARUBI”
Rruga Kolë Idromeno, nr. 32
Shkodër, Shqipëri
+355 22 400 500
info@marubi.gov.al
www.marubi.gov.al

E themeluar si Zyra e Parë e Shtypit në Shqipëri në vitin 1920, menjëherë pas Çlirimit, më 29.12.1944, ajo u shndërrua në ATSH (Agjencia Telegrafike Shqiptare) – institucioni i vetëm informativ i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë gjatë diktaturës, me synim përhapjen e informacionit zyrtar mbi veprimtarinë ideologjike, politike, ekonomike, kulturore e shoqërore që zhvillohej në Shqipëri, si dhe mbi ngjarjet politike në botë.

Agjencia ishte “Pallati i Lajmeve”. Aktiviteti i saj mediatik artikulohej ndjeshëm edhe përmes shërbimeve fotografike, të cilat pasqyronin veprimtaritë e ndryshme që zhvilloheshin kudo në vend, përçonte në masat popullore politikën dhe arritjet e ndërtimit socialist dhe u siguronte shtypit apo organizatave të interesuara imazhet përkatëse.

Si burim kryesor i informacionit për propagandën e Partisë, për shtypin, radion e televizionin shqiptar, qasja e saj mbështetej në parimet marksiste-leniniste të PPSH-së, si dhe në mësimet e Enver Hoxhës mbi gazetarinë popullore.

Në kërkimet e bëra në arkivin fotografik të ATSH-së, është hequr dorë nga mëtimi i gjithëpërfshirjes dhe shterrimit të këtij burimi të stërmadh, dhe është nisur nga disa vetí thelbësore të mediumit fotografik: pozimi dhe prania e fotografit si përshkrues apo formues i imazhit, herë duke mos u vënë re e, herë duke ndikuar me sugjerimet e tij.

Kjo ekspozitë ka përzgjedhur nga ATSH-ja vetëm imazhet fotografike të një periudhe dhe procesi të posaçëm, duke u mbështetur në një paradoks që flet sa për një kohë të caktuar, aq edhe për fotografinë. Është zgjedhur një periudhë politike (1945–1961), kohë kur diktatura shfaqte hapur qëndrimin e saj agresiv e kërcënues kundrejt personave që kishin një qëndrim ndryshe, duke mbjellë një ndjenjë frike e pasigurie ndaj njerëzve dhe duke rritur pacënueshmërinë e plotfuqinë e saj.

Ajo çka vlen të theksohet është se dënimet më të pamëshirshme, nga të cilat shumë prej të akuzuarve përfunduan në litar, para skuadrave të pushkatimit, apo u kalbën për dekada në burgje e kampe pune, u kryen në mjedise ku parësor ishte spektakli, fiksioni, konkretisht në salla kino-teatri. Praktikisht, në ato skena me plate e lozha, ku luhej jeta a vdekja në praninë e një publiku, gjyqet u zhvilluan në seanca të gjata e të njëpasnjëshme.

Kjo direktivë për të shpërfaqur publikisht e me arrogancë ritin e vënies se drejtësisë, rezulton të kthehej në një spektakël ankthi. Dënimet në grup të individëve janë fotografuar nga i njëjti kënd, nën të njëjtin ndriçim, me të njëjtën rekuizitë: të njëjtin mikrofon, të njëjtin parmak skenografik. Në rropatjen shpresëpakë, të akuzuarit, brenda të njëjtit mjedis, ‘luanin’, si të kapur në grackë, të njëjtin ‘rol’: atë të fajtorit. Apologjitë e tyre, edhe pse ishin në vendin dhe kushtet e deklamimeve aktoriale, ndonëse gjestet mund të dukeshin të tillë, nuk niseshin aspak nga këto premisa. Dënimi i paracaktuar i tyre flet për gjyqe-farsë (asnjeri prej të dënuarve nuk ia doli të fitojë pafajësinë).

Sot, ky akt regjistrimi fotografik, megjithëse këndi i pamjes mund të ketë qenë i përcaktuar nga direktiva e regjimit, na tregon, padyshim, edhe një pikëpamje tjetër: nxjerrjen në pah të diçkaje që nuk kishte ndërmend të shfaqte: një gjyq të fotografisë së gjyqeve.

Originally established as the First Press Office in Albania in 1920, the institution underwent a transformation immediately after Liberation. On 29.12.1944, it became the Albanian Telegraphic Agency (ATA). During the dictatorship, ATA stood as the only informative body within the People’s Socialist Republic of Albania aimed at disseminating official information regarding ideological, political, economic, cultural and social activities within Albania, as well as global political events.

The Agency was the ’Palace of News’. Its media activities were notably articulated through photographic services, showing various activities taking place throughout the country, disseminating the policies and accomplishments of the socialist construction, and providing the press or interested organizations with respective images. and providing respective images for the press or the concerned organizations.

As the primary source of information for the Party’s propaganda, for press, radio and the Albanian television, its approach was rooted in the Marxist-Leninist principles of the Party of Labour of Albania (PLA), as well as in the teachings of Enver Hoxha on popular journalism.

The ATA photographic archive researches have not followed to the practice of all-encompassing and thorough exploration of this vast source. Instead, the focus has shifted towards some fundamental aspects of the photographic medium: the posing of the subject and the presence of the photographer as a descriptor or shaper of the image, at times going unnoticed and at others influencing it with its suggestions.

This exhibition exclusively showcases photographic images of the ATA from a specific period and process which lean into a paradox, speaking as much about a certain time frame as it does about photography itself. It focuses on a political period (1945–1961), a time when the dictatorship openly displayed its aggressive and threatening stance towards individuals who held dissenting views, instilling a sense of fear and insecurity among people and augmenting its absolute power.

What’s noteworthy is that the harshest punishments, many of which led to hangings, executions by firing squads, decades of imprisonment and labor camps, took place in environments where spectacle and fiction were paramount— in cinema-theater halls. In those stages, with stalls and loggias where life or death was played out in front of an audience, the trials unfolded across long and consecutive sessions.

This directive to arrogantly showcase the ritual of dispensing justice by the relevant authorities turned into a spectacle of anxiety. The collective sentences imposed on individuals were recorded from the same perspective, under the same lighting, with the same object requirements: the same microphone, the same staged ledge. In a hopeless attire and within the same environment, the accused ’acted’ as if caught in the trap of the same ’role’: that of the guilty party. Their defenses, although articulated in the setting and circumstances reminiscent of theatrical performances and despite their gestures possibly appearing as such, did not stem at all from those premises. Their predetermined sentencing speaks of farce trials (none of the accused managed to prove their innocence).

In present times, this act of photographic documentation, despite its viewpoint potentially dictated by the regime, it undeniably presents another perspective: exposing something that was not intended to be shown; a trial of the photography of the trials.


© ATSH, Qemal Vrioni, 1945


© ATSH, Fejzi Alizoti, 1945


© ATSH, Fran Mirakaj, 1946


© ATSH, Mark Çuni, seminarist, 1946


© ATSH, Musine Kokalari, 1946


© ATSH, Suat Asllani, 1946